

# Luan Lusha




GJYQITAR PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

Deklaratat e analizuara:

**14 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2016)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016




↗ Pasuria bruto është rritur 20 herë.

+ 2,047,811 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash




Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



Person Fizik



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura paga nga funksioni	14,462,411	18.7%
Të ardhura nga paga e familjarëve	2,528,493	3.3%
Të ardhura nga biznesi i familjes	51,027,101	66.0%
Të ardhura nga toka bujqësore dhe prodhime blegtorale familjare	5,576,000	7.2%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	219,520	0.3%
Të ardhura të tjera	3,484,838	4.5%
<b>Total</b>	<b>77,298,363</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Gjatë viteve të deklarimit, subjekti rezultoi të ketë investuar në biznes familjar lokal në Spille të Kavajës respektivisht; në vitin 2008 me vlerë 1,200,000 lekë, i rindërtuar në vitin 2016 me vlerë 1,100,000 lekë. Gjatë viteve janë investuar gjithashtu 2,276,000 lekë në çadra dhe shezllone plazhi në Spille dhe Golem, Kavajë, duke gjeneruar të ardhura nga ky biznes me vlerë 24,447,516 në total.

Investimet në truall/tokë arë në Spille+Golem rezultojnë në vlerë 4,000,000 lekë, ndërsa të ardhura të gjeneruara nga shfrytëzimi bujqësor dhe blegtoral i tyre në vlerë 5,567,000 lekë. Në vitin 2014, bashkëshortja e deklaruesit jep hua në vlerë 2,000,000 leke pa interes, hua e cila do i shlyhet në vitet në vazhdim.

Sërish në vitin 2014, subjekti deklaroi shtesë aseti "Kontratë porosie për shtëpi banimi në Tiranë" në vlerë 33,400 euro, të cilin e shlyen gjysmën në vitin 2014 dhe gjysmën tjetër në vitin 2015.

Në vitin 2016, deklaruesi rezultoi të ketë detyrime huaje ndaj personave të tretë në vlerën 10,000 euro dhe 500,000 lekë të marra për rindërtimin e lokalit.